Regjistrimet në shërbimet shkollore:

Pre/post shkolla- Transporti-Ulje e tarifës së mensës- Dieta të veçanta

Viti shkollor 2022/2023

Shërbimet shkollore ju drejtohen të gjithë nxënësve të shkollave të Cassano d'Adda prindërit e të cilëve, ose prindi i vetëm (përgjegjsi ligjor i fëmijës) punojnë.
Kërkesat duhet të paraqiten duke filluar nga data 27/6/2022 dhe brënda datës 16/08/2022.

Administrata e komunës mund të hapë sërish data të tjera vetëm në qoftë se ka ende vende të lira dhe e komunikon nëpërmjet adresës së internetit.
Gjatë fazës së regjistrimit mund të kërkohet shërbimi shkollor për të gjith vitin ose vetëm për një pjesë të tij.

Në rast kur kërkesat kalojnë numrin e disponueshëm dhe të ardhurat nuk mjaftojnë për të hapur një shërbim të ri, hapet një listë pritjeje e cila e shpjegohet më qartë në " Linee Guida ai Servizi Scolastici" e publikuar në internet.
Shërbimet shkollore ju drejtohen vetëm atyre familjeve që nuk kanë borxhe me shërbimet shkollore, në rast të kundërt regjistrimi mund të refuzohet.

Tarifat e këtyre shërbimeve janë të përcaktuara nga Këshilli i komunës.

MËNYRAT E REGJISTRIMIT

Kërkesat për shërbimin e transportit shkollor- pre dhe post shkollor- ulja e tarifës së mensës- dieta të veçanta- paraqiten në mënyrë digjitale nëpërmjet Sportello Telematico Polifunzionale të Spazio città në paragrafin "servizi scolastici culturali e sportivi":

Ristorazione scolastica (mensa), link: andare alla mensa scolastica
Transporti shkollor, link: andare a scuola con lo scuolabus
Pre dhe post shkollor, link: andare al pre e post scuola

Për të paraqitur këto kërkesa është i nevojshëm identifikimi me CNS(tessera sanitaria) CIE(Carta e identitetit elektronike) ose SPID (Sistemi publik i identitetit digjital).
Në qoftë se kërkesa është bërë në mënyrë të rregullt, sistemi ju nis një email për konfermim. Duhet të hyni përsëri në portalin e mëparshëm dhe të konsultoni datën dhe numrin e protokkolit të praktikës suaj dhe ti mbani mënjanë sepse listat plotësohen duke përdorur këta dy elemente.
Keni mundësi tju drejtoheni zyrave të Spazio Città për:

- tju lëshuar SPID dhe PIN e CSN(tessera sanitaria) dhe CIE (Carta e identitetit elektronike)
- Tu paraqitur në sportelin e ri "Online insieme", i aktivizuar nga komuna për tju ndihmuar në paraqitjen e kërkesave telematike. Sporteli është i hapur në oraret më poshtë
  E hënë, e martë dhe e shtunë nga ora 8:30 deri në orën 12:30
  E enjte nga ora 9:00 deri në 12:30 dhe nga 14:40 deri në 18:40;

Për të lënë takim me zyrat e Spazio Città është e mundur:
- të nisni një email në demografici@comune.cassanodadda.mi.it duke shënuar dhe numrin tuaj të telefonit për tju kontaktuar
- të telefononi në numrin 0363 366226 në oraret që sportelet e Spazio Città janë të hapur

Kërkesat që vijnë me email ose me mënyra të ndryshme nga ato që përshkruam më sipër nuk merren parasysh.

Shërbimet pre dhe post shkollor

Kostoja i shërbimit pre-post shkollor për vitin shkollor 2022/2023 të miratuara nga komuna shënohen më poshtë:

Tarifat pre dhe post shkolla 2022/2023	
Tipi i shërbimit	Tarifa mujore
Pre shkolla e kopshtit Cristo Risorto-Groppello-Cascine (30min)	15 €
Pre shkolla fillore (1 orë)	30 €

Post shkolla fillore (1orë)	30 €
Post kopshti i Groppello (1,5 orë)	45 €
Post 1 orë kopshti i Cristo Risorto (1orë)	30 €
Post 2 orë kopshti i Cristo Risorto (2 orë)	60 €

për shërbimet pre dhe post shkollore për vitin shkollor 2022/2023 Komuna ka vendosur siç spjegohet më poshtë:

- shërbimet pre dhe post shkollor janë me pagesë në të gjitha shkollat ku aktivizohen
- Shërbimet pre dhe post shkollor aktivizohen vetëm nëse numri i nxënësve të regjistruar është i barabartë ose më i madh se 10
- Në të gjitha shkollat ku aktivizohen shërbimet e mësipërme merenda e pasdites duhet tju jepet fëmijëve nga familjet.

Për të vërtetuar gjendjen e punës së prindërve është e mundur:

1. Ti pashkangjitet kërkesës së regjistrimit edhe deklarimi i punëdhënsit

OSE

2. Të plotësoni pjesën e modulit të regjistrimit ku kërkohen kushtet e punës së prindit.

Administrata e komunës do të mbikqyrë mënyren e frekuentimit të fëmijëve në këtë shërbim: në rast mungesash të zgjatura për një periudhë më të gjatë se tre javë dhe në mungesë të justifimit të shkruar dhe të dokumentuar, kjo mund të sjellë heqjen e fëmijës nga shërbimi dhe të të futen fëmijë të tjerë që janë në listen e pritjes.

SHËRBIMET E TRANSPORTIT

Kostoja e shërbimit të transportit shkollor për vitin shkollor 2022/2023 të miratuara nga komuna janë të paraqitura në tabelë më poshtë :

Tarifat e transportit shkollor për vitin shkollor 2022/2023	
Tipi i shërbimit	Tarifa mujore
Linea e vajtjes	24 €
Linea e ardhjes	24 €
Linea e vajtjes dhe e ardhjes	48 €

Për shërbimin e transportit për vitin shkollor 2022/2023 Administrata e komunës ka vendosur:
-shërbimi është falas për nxënësit e regjistruar në shkollën e Cascine San Pietro
-ulje 30% në rast se ka motër/vëlla të regjistruar në të njëjtin shërbim
-ulje 50% kur ka më shumë se një motër/vëlla të regjistruar në të njëjtin shërbim.

- shërbimi i transportit është me pagesë edhe për studentët e tetëvjeçares që banojnë në Cascine San Pietro.

Të katër linjet e autobusit shkollor dhe ndalesat përkatëse mund ti gjeni në adresen e internetit të Spazio Città.
Pasi familja të ketë zgjedhur linjen që i intereson duhet të regjistrojë detyrimisht ndalesat e vajtjes dhe të ardhjes.
Pasi të përcaktohen listat e shërbimeve shkollore pre dhe post shkollore dhe transporti ato publikohen në adresen e internetit zyrtare. Duke respektuar normat ligjore per privacy listat do të paraqiten me numrin e protokollit dhe daten e paraqitjes së kërkesës dhe jo me emrin e nxënësve.

PËRMBLEDHJE E MËNYRAVE TË PAGESËS TË SHËRBIMEVE SHKOLLORE PRE E POST DHE TRANSPORTIT

Përsa i përket shërbimit të transportit shkollor, pre e post shkollor Administrata e Komunës ka miratuar disa tarifa dhe " udhëzime mbi këta shërbime " të cilat vijojnë më poshtë:

1. Shërbimet ju mundësohen vetëm atyre familjeve që nuk kanë borxhe mbi këta shërbime me shkollen sepse në rast të kundërt kërkesa mund të refuzohet; shërbimet gjithashtu mund të shkëputen në rast se pagesat nuk rezultojnë të rregullta dhe nuk paguhen brënda afatit të përcaktuar.
2. Dokumentat e pagesës duhet të jenë në emër të prindit që bën kërkesën e shërbimit. Në kërkesë duhet të paraqiten në mënyrë të saktë të dhënat personale- kodi fiskal- adresa- numri i telefonit dhe adresa e emailit e prindit.

a). Tarifat e shërbimeve shkollore janë mujore dhe fikse pavarsisht nga numri i ditëve që përdoret shërbimi gjithashtu për ditët që shërbimi nuk shfrytëzohet nuk mund të ketë rimborsim të parave, duke përjashtuar rastet kur shërbimet pezullohen nga ana e Administratës së Komunës për arsye të pa parashikuara.
3. Kërkesa për të paguar tarifën vjetore të shërbimeve të transportit shkollor, pre e post shkollor, bëhet dy herë gjatë vitit shkollor: e para brënda datës 30 shtator, dhe e dyta brënda datës 31 janar.
4. Qytetarët mund të heqin dorë (pjesërisht ose komplet) nga shërbimi i kërkuar para datës 30 shtator ose para datës 31 janar për periudhën janar-qershor. Heqja dorë nga shërbimi e paraqitur pas këtyre datave të përcaktuara, në pikën e mësipërme, nuk japin të drejtë të kthimit pas të parave.
5. Në rast pagesash të gabuara ose më tepër seç duhet Comuna merr masa që me pagesat në vazhdim të reduktojë shifrën.
6. Dokumentat e pagesave të kryera për shërbimet pre e post dhe transport shkollor duhet të ruhen nga familjen ashtu siç e parashikon ligji.
7. Mungesa e pagesës, të tarifës për shërbimet e tranposrtit dhe pre e post shkollor, para datave të përcaktuara sjell automatikisht përjashtimin nga shërbimi përkatës dhe zëvëndsimin me nje nxënës tjeter që është në listen e pritjes, në rast ku thirret familja për të paguar tarifën e mbetur mrapa dhe per të gjetur një plan për të rifutur fëmijën në shërbim, dhe familja nuk e respekton.

Saktësohet se në raste emergjente, për situata të pa parashikuara, kërkesat e pagesave të këtyre shërbimeve mund të psojnë nryshime ose pezullim.

Për shërbimet e transportit dhe pre e post shkollor për vitin shkollor 2022/2023 janë parashikuar këta ulje tarifash:

- Ulje 50% për muajin e shtatorit për fëmijët që frekuentojn shkollën fillore dhe tetëvjeçare ;
- Ulje 25% për muajin e shtatorit për fëmijët që frekuentojnë kopshtin;
- Ulje 25% në muajt e dhjetorit dhe janarit për të gjithë nxënësit;
- Ulje 25% në muajin që i bien pushimet e Pashkëve për të gjithë nxënësit;
- Ulje 50% në muajin e qershorit vetëm për nxënësit e shkollave fillore dhe tetëvjeçare;

MENSA SHKOLLORE

Imformacjonet e mëposhtme, përsa i përket shërbimit të mensës shkollore, janë të vlefshme deri në përfundimin e proçedurave të garës për të zgjedhur biznesin që do të kryejë këtë shërbim.

KËRKESA PËR DIETA TË POSAÇME

Është e mundur të paraqiten kërkesa për dieta të posaçme në rastet e mëposhtme:

DJETA ETIKO FETARE :
Kërkesa mbetet e vlefshme deri në përfundimin e ciklit shkollor ose deri ne paraqitjen me shkrim të dorëheqjes nga kjo djetë. Prandaj kërkesat e paraqitura vitin e kaluar janë të rinovuara automatikisht.

DJETA PËR SEMUNJDJE KRONIKE
Kërkesa për djeta të posaçme për sëmunje kronike (celiachia etj) **me çertifikatë mjeksore, siç e kërkon ATS,** ka vlerë për të gjithë ciklin shkollor ose deri në paraqitjen e një kërkese me shkrim ku hiqni dorë nga kjo djetë.

DJETA PËR ALERGJI NDAJ USHQIMEVE
Për këtë lloj kërkese është e nevojshme të paraqitet përçdo vit dhe të bashkangjitet **çertifikata e mjekut siç e kërkon ATS.**

Për të garantuar një organizim sa më të mirë të shërbimit është e domosdoshme që kërkesat e djetave të posaçme të paraqiten kohë përpara fillimit të vitit shkollor.
Kërkesat duhët të paraqiten on line në adresen e internetit të Spazio Città duke ndjekur udhëzimet e përshkruara në paragrafin "Mënyrat e regjistrimit" në këtë dokument.

MËNYRA E KËRKESËS PËR ULJEN E TARIFËS SË MENSËS SHKOLLORE PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023

Banorët e Cassano D'Adda mund të kenë ulje të tarifave të mensës shkollore, gjatë regjistrimit dhe para fillimit të vitit shkollor është e domosdodhme plotësimi i modulit të kërkesës on line nëpërmjet adresës së Spazio Città duke ndjekur udhëzimet në paragrafin "Mënyrat e regjistrimit" në këtë dokument.
Kërkesa, ku duhet vënë shifra e ISEE, **do të ketë vlerë për të gjithë vitin shkollor.**
Për kërkesat e uljes së tarifës së mensës të paraqitura pas fillimit të vitit shkollor, ulja do të jetë e vlefshme duke filluar nga dita që paraqitet kërkesa dhe vaktet e konsumuara deri atë ditë do të aplikohet tarifa e plotë.

	Fasha ISEE	**Tarifa e reduktuar ***
fasha 1	nga €0,00 deri €6.000,00	2,24 €
fasha 2	nga €6.000,01 deri €12.000,00	3,77 €
fasha 3	nga €12.000,01 deri €18.000,00	4,93 €
fasha 4	nga €18.000,01 e më sipër	5,23 €

*përveç rasteve të përshtatjes ISTAT o ose tarifa të nryshme te vendosura nga gara që po vazhdon

Tarifa e mësipërme do të pësojnë një rritje gjatë vitit shkollor pas përfundimit të proqedurës së garës që do të vendosë biznesin që do të drejtojë këtë shërbim.

Do të aplikohet tarifa e fashës më të ulët nga ajo përkatëse vetëm në rastet e mëposhtme:
a) në rastet e atyre familjeve ku ISEE është e barabartë ose më e ulët se 20.000 euro dhe ka tre ose më shumë fëmijë të mitur dhe të paktën dy prej tyre të frekuentojnë mensën shkollore (ulja bëhet vetëm për një fëmijë);
b) Në rast të atyre familjeve të përbëra vetëm nga një prind dhe me ISEE të barabartë ose më të ulët se 12.000 euro dhe me të mitur në ngarkesë (ulja bëhet vetëm për një fëmijë);
c) Në rast të ndryshimit të situatës ekonomike familjare si pasojë e ndryshimit të situatës së punës të nga 6 muaj nga paraqitja e ISEE, e dokumentuar nga një deklaratë e e posaçme (deklaratë e pushimit nga puna ose regjistrimit në zyrat e punës) dhe ISEE e fundit.
Administrata e komunës do të verifikojë deklaratat e paraqitura.

Për vitin shkollor 2022/2023 do të aplikohet tarifa maksimale në rastet e mëposhtme:
- nxënësit që nuk janë banorë në komunën e Cassano D'Adda (përjashtohen ato raste ka marrveshje mes komunave të banimit);
- Mosparaqitja e kërkesës së uljes së tarifës

- Në raste ku ISEE nuk është e plotë dhe në raste ku ISEE është e rreme;
- Në ato raste ku në ISEE ka të shënuar brobleme të vërtetuara nga INPS

Në raste të veçanta ku ka situata shumë të vështira ekonomike , pas vlersimit të hollësishëm të shërbimeve socjale të komunës, mund të ketë ulje të mëtejshme ose shërbim falas.
Në adresën on line të komunës "Note informative", do të jetë në dispozicjon brënda pak kohësh në gjuhët e mëposhtme:
arabisht, spanjisht, frëngjisht, anglisht, gjuha kineze dhe gjuha shqipe.
Për informacjone të mëtejshme mund të shikoni " Linee Guida ai Servizi Scolastici " të publikuara on line në adresën e Spazio Città e Komunës së Cassano D'Adda.
Zyra e arsimit publik dhe asistenza e edukimit e Komunës janë në dispozicjonin tuaj për sqarime të mëtejshme në:
Adresa email: serviziscolastici@comune.cassanodadda.mi.it
Shërbimet e personave në numrin: 0363 366 253 (nga e hëna në të premte nga ora 9.00 deri 12.30 dhe të martë e të enjtë nga 14.30 deri 16.00)